



Jetë të shkruara me laps mbi një petal trëndafili

Cikel poetik nga Anna Montella

Përktheu Arjan Kallço

ANNA MONTELLA është operatore kulturore dhe për komunikimin, shkrimtare, gazetare, eksperte në marketing dhe komunikim shoqëror. Nga viti 2017 është sekretare e Dhomës së Poetëve. Ka ideuar Kafe letrare: Hëna dhe Dragoi, projekt kulturor në kuadrin e së cilave organizon konkurse dhe evente kulturore. Është anëtare e Jurive e shumë Çmimeve letrare. Ideoi Çmimin Zëra mesdhetarë. E impenjuar në shoqëri merr pjesë në recuperimin e memories historike. Ka marrë disa çmime si: Çmimi për kulturën 2020, Ekselencia e territorit në 2018, Çmimin special Thesaurus 2016. Në vite ka botuar disa libra: Aromë bajamesh të hidhura 2002, Shpirti në pasqyrë 2013, Stina në mes 2014, Dhe e shikoj botën nga një dritare 2016, Krokodilin tim e shkuaj vetë 2019, Shiu është një gjendje shpirtërore 2020.

TRËNDAFILAT QË NUK I MBLODHA
Shi fijeartë e pluhur vjesh
Trëndafilat që dot s'i mblodha
janë gjithmonë më të bukur.

Bardhësi virgjërie e një fustani nusërie
Jetë të shkruara me laps mbi
një petal trëndafili
Aliçja në një vend me mrekulli të përjetshme
Kurora të shkëlqyeshme në fundet e shisheve...

Ëndrra e Lindjes në qëndisjen e një shalli
Trëndafilat që dot s'i mblodha në një fluturim
fluturash.

Zonja e kështjellës në një përrallë të gabuar
I zgjidhi gërshetat e veta bukuroshja e fjetur
Aliçja librin e mbylli dhe shtriga u zgjua...

Netë me hënë të plotë dhe
xixëllonja të argjendta
Trëndafilat që dot s'i mblodha kanë
aromë ere.

Të lra tashmë nga një ëndërr e krijuar në letër
Gra në difë me diell dhe ditë me furtuna
Ciganja në magjinë e një libri të kristalltë
Sy të shndritshëm ambre dhe buzë koral
Fate që gërshetohen në një pëllëmbë dore
Bija të një kohe tjetër padrone të botës...

Varëse guackash dhe byzylykë në duar
Të kuqe dhe plot aromë janë trëndafilat
që dot s'i mblodha.

NETËVE

Drapëri i hënës në një fije ere
Në blunë e thellë një yll i argjendtë
Troket nata me histori magjepsëse
E endur me ëndrra, me duar shtojzovallësh...
Hapa të butë...
Një mace syhapët u ndal
Tek dëgjonte një tingull të paqartë...
Prej bufit thirrja e lashtë në qiell
Një e qartë fëmije përhumbet, larg...
Më pas gjithçka qetësohet, një frmëmarrje e
thellë
E mbush natën, atë të Natës...
Në heshtjen që duket e zyshtur
I mundur, gjigandin e zuri gjumi...
Kjo është ora e dëshirave
E gjezteve të lashta dhe e mijëra mistereve
Ora kur kthehen ëndrrat e rrëmbyera
Të përhumbura të humbura të harruara
Kur keqardhja për histori të papërbushura
Duket kujtime të jetës së jetuar
E gati duket se qielli larg
Mund të ciket me një të zgjatur të dorës.

FLUTURIMI I FENIKSIT

... me britma të pazë do të end rrjeta heshtjesh
Do ta lë erën ta fshijë zërin tim
Do ta vesh shpirtin tim lakuriq me rreca me
ngjyrë
Dhe do të ee nëpër shtigje pa emër
Shtjella rëre do të m'i mbulojnë gjurmët...
Hapi im i lehtë do të humbasë



Prej shumë vajzave Zonja Fat
Nuk i la as edhe një...

Por në trapazanin mes pëlhurit dhe merimaga-
gave

Nuk mërzitemi, numërojmë vitet
Dhe mes kujtimesh, më të ëmblat dhe më të hi-
dhurat,

Janë shtrigat dhe kusarët...
Është dita e parë dridhëse e shkollës

Përparsja e zezë dhe aroma e vjollcës
...ishin treqind, ishin të rinj dhe të fortë...

Historia mashtron...kurrë nuk vdiqën,
Në shtëpinë e Gjyshes Shpresë

Karlota vazhdon vallëzimin
e saj të përjetshëm...

Fletore kuq e zi me vija
Aromë fëmijërie dhe kujtime të rrëmbyera

Dashuria e parë, dhimbja e parë
Lotë të kaltër në një rreze dielli

Një ëndërr e paqartë, një portret i zbehtë
Rigjen përvijime me majën e gishtit...

Zonja Dorë buzëqesh mes lotëve
Notat e humbura u shndërruan në këngë

Dhe në dhomat e kujtesës
Ende ndihet aroma e vjollcës.

MOS U NDAL PAK

...dhe nëse një ditë
Ti duhet të kthehesh

Në vendet që të panë
Tek qeshje, qaje, ëndërroje
Mos u ndal një çast...
E shkuara nuk ekziston më
Në arratisjen drej dhomave
Të kujtesës
Nuk do të mund ta gjesh më
Vetveten si ishe.
E përhumbur,
Është arratisur edhe ajo
Bashkë me kujtimet
Të rrëmbyera tutje
Me pëlhurin e kohës.

Çliroji pallamarët
Nga deti i kujtesës
Në aventurat
Ndër tallazet e të sotmes.
Lëre që barka jote

E çankoruar
Ta ndjekë rrymën
Mos i bëj rezistencë
Lëshoji flokët
Dhe kapërcije furtunën.
Jetoji ditët e tua
Mos e ki frikë të ardhmen.
Ajo që do të vijë
Ende do ta ketë shikimin tënd.

DITË DHE HIJE

Malinkonia e hollë
E një rruge në perëndim
Në magjinë surreale
Të fenerëve të vjetër...

Nëpër rrugët e vetmuara
Jehona dridhëse i pasioneve të lashta...
Të burgosura në kujtime
Vendesh
Në kohët ët tjera të jetuara
Figura të heshtura
...vallëzojnë...
Prej notave të melodive
Të humbura...

**DHE KTHEHET HERË
PAS HERË PRAPË RINIA**

Vitet e mrekullueshme të mundimeve
Vrap me "tallazet e zemrës"
Dashuritë adoleshente, gënjeshttrat e ëmbla
Ai kuptim vagëllues nga turpi

Lumi rrjedh
Që nuk e njeh grykëderdhjen
Të shumta pranverat dhe
fluturimet guximtare
Vargjet e kënduara me gjysmë zëri
Ëndrrat dhe ideat të pafashitura kurrë

Ndjekin njëra-tjetrën agimet dhe stinët
Vera kalon shpejt dhe u ngrys tashmë
Ku përfunduan këngët
Sa larg që je pranvera ime

E megjithatë...mjafton një fllad i lehtë
... dhe herë pas here kthehet prapë rinia.